



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



Nr 12-030-22883 dt. 29.06 2020

Bazuar në nenin 11, 12 dhe 40, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, nenit 34, pika 34.6, të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 3.2 të Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012 MPB-03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, si dhe pas ndryshimeve dhe disa doreheqjeve nga pozita të disa anëtarëve të KKSB-së, nenit 49 të Ligjit Nr. 05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë 29.06. 2020, miratoi këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin e anëtarëve të KKSB-së

Neni 1

Më këtë propozim vendim kërkohet zëvendësimi i këtyre anëtarëve të KKSB-së:

1. Z. Tafil Halilaj, zëvendësohet me Muhamet Gjoka (Drejtorja e Arsimit),
2. Z. Xhavit Bytyqi, zëvendësohet me Arben Haziri (KKP),
3. Z. Armend Garaj, zëvendësohet me Muhamet Ramadani (KLSP-ja Komoran).

Neni 2

Më këtë propozim vendim anëtarët e zgjedhur janë të obliguar që t'i kryej detyrat dhe t'i marrin përgjegjësit sipas ligjit për vetëqeverisje lokale dhe legjislacionit tjetër në fuqi.

Neni 3

Me këtë propozim Vendim do të njoftohen anëtarët e KKSB-së , Kryetari i Komunës, Drejtoratet përkatëse, si dhe Zyra e Personelit.

Neni 4

Për monitorimin dhe zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset: Kryetari i Komunës së Drenasit dhe Zyra e Kuvendit..

Neni 5

Ky vendim hynë në fuqi pas miratimit nga Kuvendi Komunal i Drenasit si dhe nënshkrimi nga ana e kryesuesit të Kuvendit të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Drejtorisë Përkatesë;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Gabinot Halilaj

